







RAPORTI I PERFORMANCËS

2025

BASHKIA KORÇË



BASHKIA KORÇË

Dokumenti bazohet në të

dhënat e Sistemit të Matjes së performancës për vitin 2025. Ky raport është prodhuar nga Bashkia Korçë me asistencën e “Bashki të Forta”, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport vlerësimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet dhe qëndrimet e SDC-së, Qeverisë së Suedisë dhe Helvetas.

Fjalor Shpjegues	3
Qellimi I Raportit.....	6
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	7
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë.....	8
SHERBIME PUBLIKE VENDORE	9
 Arsimi Paraniversitar	9
 Menaxhimi i Mbetjeve	16
 Mbrojtja nga zjarri.....	19
 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.....	22
 Administrimi i pyjeve dhe kullotave	25
 Mbrojtja Sociale.....	28
QEVERISJA E MIRE.....	33
 Burimet Njerëzore	34
 Transparenca	38
 Barazia Gjinore	40
EU Integrimi në BE	44
MENAXHIMI FINANCIAR	47
Përfundime dhe Rekomandime.....	51

FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kritereve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integriteti në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky

sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njërive të vetëqeverisjes vendore.

Sherbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Këto përfshijnë, ndër të tjera, , ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe cerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas perkufizimit the ligjit "janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative'

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mbliidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve ne cdo fushe paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. "Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara").
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2024 / 2025	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: $(\text{Vlera 2025} - \text{Vlera 2024}) / \text{Vlera 2024} \times 100$.

Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓) Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2025 – Vlera 2024). Simboli i Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet

Semafori

Vlerësim vizual i nivelit të performancës:

● = vlerë absolute ndryshimi pozitiv

● = vlerë absolute ndryshimi negative.

● = nuk ka ndryshim (vlera mbetet e njëjtë)

○ = mungojnë të dhënat (nuk raportohen vlera për një ose të dy vitet).

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm “vlera positive ndryshimi = jeshile”. Ky rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv.

Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës. Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- Shpenzimet administrative (ulja tregon efikasitet).

QELIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë Korçë

Bashkia Korçë është një nga njësitë vendore më të zhvilluara dhe më të strukturuar të juglindjes së vendit, që luan rol qendror në zhvillimin ekonomik, kulturor dhe administrativ të rajonit. Ajo përfshin një **territor të gjerë prej 795.312 km²** me një **popullsi rreth 60754 banorë (Cens 2023)**, ku ndërthuren karakteristikat urbane të qytetit të Korçës me zonat rurale me potencial të lartë bujqësor e natyror. Qyteti ka ndërtuar një **identitet të fortë ekonomik e kulturor**, duke qenë qendër e arsimit, artit dhe turizmit në juglindje, ndërsa zonat përreth përbëjnë një bazë të rëndësishme për prodhimin bujqësor, përpunimin e produkteve lokale dhe zhvillimin e turizmit natyror e kulinar.

Në vitet e fundit, bashkia ka ruajtur **stabilitet fiskal dhe menaxhim të qëndrueshëm të shërbimeve publike**, duke u renditur ndër bashkitë me performancë të lartë në arsim, shërbimin zjarrfikës, mbrojtje sociale, barazi gjinore dhe transparencë.

Në përmbledhje, **Bashkia Korçë përfaqëson një model të stabilitetit institucional dhe administrativ**, por për të ruajtur këtë pozicion dhe për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik, kërkohet një **qasje e integruar që lidh politikat sociale, ekonomike, mjedisore dhe arsimore**.

Theksi për periudhën e ardhshme duhet të vendoset te **zhvillimi rural dhe bujqësia me vlerë të shtuar, digjitalizimi i shërbimeve, nxitja e turizmit të qëndrueshëm dhe përfshirja e brezit të ri në ekonomi**.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2025
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë	60754 (cens 2023) 128495(Regjistër i Gjendjes Civile)
Sipërfaqja totale e bashkisë në km2	795.312
Sipërfaqe njësisë qendër në km2	20.312
Sipërfaqja e njësive administrative në total në km2	775
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	20317
Numri total i njësive administrative të bashkisë	7+1(Qendër)
Numri i fshatrave	63
Punonjës të bashkisë në total	1143
Numri total i punonjësve femra të bashkisë	541
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	602
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	291

SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësi të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në këtë kuadër, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore të aprovuara edhe në kuadër të raportit kombëtar të performancës bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimit parauniversitar (ku hyjnë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjere vendor që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë në ofrim ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë përparimet e arritura, objektivat dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.



ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm:

Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- Funksioni 23.11: “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.”
- Funksioni 23.12: “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.”

Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre. Kjo përfshin ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore (23.11), si dhe administrimin e plotë të sistemit parashkollor (kopshte dhe çerdhe) përmes funksionit 23.12, që përfshin menaxhimin e stafit ndihmës, mbështetjen logjistike dhe rregullimin funksional të shërbimit.

Funkcioni i arsimit parauniversitar në Bashkinë Korçë përfshin administrimin e institucioneve parashkollore (çerdhe dhe kopshte), si dhe mirëmbajtjen e godinave të arsimit bazë dhe të mesëm të përgjithshëm. Bashkia ka një traditë të gjatë në ofrimin e arsimit cilësor dhe një rrjet të konsoliduar institucionesh publike, të cilat plotësohen nga një numër i vogël institucionesh private. Përgjegjësitë kryesore të bashkisë përfshijnë sigurimin e kushteve infrastrukturore, funksionimin e rregullt të çerdheve dhe kopshteve, dhe bashkëpunimin me Drejtorinë Arsimore Rajonale për garantimin e standardeve kombëtare të arsimit.

Analiza e performancës

Analiza e treguesve të arsimit parauniversitar për vitin 2025 evidenton një situatë **përgjithësisht të qëndrueshme** në sektorin arsimor të Bashkisë Korçë, me përmirësime në disa indikatorë të cilësisë dhe mbështetjes institucionale, por edhe me sfida të lidhura kryesisht me rënien demografike dhe uljen e numrit të nxënësve.

Në lidhje me mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore, niveli mbetet i pandryshuar. Institucionet arsimore (çerdhet, kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare publike) rezultojnë të mirëmbajtura. Gjatë periudhës në analizë nuk raportohen rikonstruksion në çerdhe dhe kopshte por vetëm në një shkollë 9-vjeçare.

Treguesit që lidhen me organizimin e procesit mësimor reflektojnë **një rënie të lehtë** të numrit të nxënësve/fëmijëve për klasë në të gjitha nivelet. Në arsimin parashkollor vërehet ulje në numrin mesatar të fëmijëve për grup, nga **15.6 në 14.5** dhe ulje në raportin fëmijë-mësues në kopshte publike, nga **11.6 në 10.7**. Kjo ulje në këta tregues, vjen si rezultat i lëvizjes demografike të popullsisë (migrimi/emigrimi) si dhe zgjedhjeve alternative (frekuentimit të kopshteve private). Në arsimin bazë, raporti nxënës/mësues është ulur nga **9.3 në 9.1**, ndërsa numri mesatar i nxënësve për klasë nga **15.6 në 15.3**. Viti 2025, rezulton dhe viti i mbylljes së një shkolle 9 -vjeçare publike në Bashkinë Korçë.


Në arsimin e mesëm publik, vërehet gjithashtu ulje në numrin mesatar të nxënësve për klasë, nga **24.2 në 22.3**.

Në lidhje me shërbimet mbështetëse dhe përfshirjen, të gjitha kopshtet publike raportohen me këshill prindërisht funksional ndërsa numri i prindërve të informuar mbi prindërimin pozitiv është rritur nga **143 në 157**. Gjithashtu, çerdhet publike rezultojnë **të furnizuara plotësisht me materiale didaktike** të parashikuara në buxhetin e Bashkisë Korçë.


Në aspektin e burimeve njerëzore, treguesi i stafit mbështetës për shkollë 9-vjeçare paraqet një rritje të lehtë (nga 1.06 në 1.08), ndërsa për arsimin e mesëm të përgjithshëm ky tregues mbetet i pandryshuar. Në tërësi, treguesit e arsimit paraqesin stabilitet në aspektin e mirëmbajtjes dhe organizimit të shërbimit, me ndryshime të kufizuara në strukturën e treguesve.

Tabelë: Arritjet dhe Objektivat

Kategoria	Përshkrimi
Arritjet 2025	-Mirëmbajtja e të gjitha institucioneve arsimore. - Ulja e raportit nxënës/mësues gjë që interpretohet si përmirësim i mundësive për trajtim më individual të nxënësve. -Ndërveprimi institucion–familje dhe forcimi i rolit të komunitetit në edukimin e fëmijëve.
Objektivat 2026	- Hartimi dhe miratimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar. - Rritje e numrit të çerdheve për shkak të rritjes së numrit të kërkesave. - Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin. -Rritja e investimeve në arsimin parashkollor. - Forcim i kapaciteteve të menaxhimit të institucioneve.



Tregues të Performancës për Arsimin parashkollor, %, 2024-2025



Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Çerdhe të mirëmbajtura kundrejt numrit total të çerdheve publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Kopshteve të mirëmbajtura kundrejt numrit total të kopshteve publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Shkolla 9 vjeçare të mirëmbajtura, kundrejt numrit total të shkollave 9 vjeçare publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Raporti nxënës/mësues në shkolla 9 vjeçare	nxënës/mësues	9.37	9.17	-0.20	↓	-2.13%	●
Tregues	Numri mesatar i nxënësve në një klasë të shkollës 9 vjeçare publike	nxënës/klasë	15.60	15.31	-0.29	↓	-1.85%	●
Tregues	Numri mesatar i fëmijëve në një klasë kopshti publik	nxënës/klasë	15.60	14.53	-1.07	↓	-6.86%	●
Tregues	Punonjës mbështetës për shkollë 9 vjeçare	punonjës mbështetës/shkollë 9 vjeçare	1.06	1.08	0.02	↑	1.88%	●
Tregues	Shkolla 9 vjeçare të rikonstruktura	numër	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Kopshte të rikonstruktura	numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Kopshte ku janë ngritur këshillat e prindërve kundrejt numrit total të kopshteve publike	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Punonjës mbështetës për shkollë mesme të përgjithshme	punonjës mbështetës/shkollë e mesme	5.33	5.33	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Numri mesatar i nxënësve në një klasë të arsimit të mesëm të përgjithshëm publik	nxënës/klasë	24.26	22.30	-1.96	↓	-8.08%	●
Tregues	Numri i prindërve të informuar në lidhje me prindërimin pozitiv për fëmijet 0-3 vjeç	numër	143.00	157.00	14.00	↑	9.79%	●
Tregues	Raporti i çerdheve të furnizuara me material didaktik kundrejt numrit total të çerdheve (në %)	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●

Tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike dhe private	nxënës/ mësues	14.55	12.51	-2.04	↓	- 14.00 %	●
Nëntreg ues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	nxënës/ mësues	11.64	10.76	-0.88	↓	-7.56%	●
Nëntreg ues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte private	nxënës/ mësues	17.46	14.27	-3.19	↓	- 18.23 %	●

Numëri	Vlera 2024	Vlera 2025	Njesia matëse
Numri i çerdheve publike të mirëmbajtuara	2	2	Numër
Numri i kopshteve publike të mirëmbajtuara	48	48	Numër
Numri i shkollave 9 vjeçare publike të mirëmbajtuara	46	45	Numër
Numri i nxënësve të regjistruar në shkolla 9 vjeçare publike	5134	5005	Numër
Numri i mësuesve që japin mësim në shkolla 9 vjeçare publike	548	546	Numër
Numri i klasave të shkollave 9 vjeçare publike	329	327	Numër
Numri i ndërtesave publike të arsimit bazë të rikonstruktura	1	1	Numër
Numri i ndërtesave publike të arsimit parashkollor të rikonstruktura	0	0	Numër
Numri i stafit mbështetës në arsimin bazë në shkollat 9 vjeçare publike	49	49	Numër
Numri i kopshteve publike ku janë ngritur këshillat e prindërve	48	48	Numër
Numri i stafit mbështetës në shkolla të mesme të përgjithshme publike	32	32	Numër
Numri i nxënësve të regjistruar në shkolla të mesme të përgjithshme publike	1553	1539	Numër
Numri i klasave në shkolla të mesme të përgjithshme publike	64	69	Numër
Numri i prindërve të informuar në lidhje me prindërimin pozitiv për fëmijet 0-3 vjeç	143	157	Numër
Numri i personelit të çerdheve publike	30	30	Numër
Numri i çerdheve publike të furnizuara me material didaktik	2	2	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike	168	173	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike	1560	1453	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private	227	214	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte publike	134	135	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte private	13	15	Numër
Numri i çerdheve publike në bashki	2	2	Numër
Numri i çerdheve private në bashki	0	0	Numër
Numri i kopshteve publike në bashki	48	48	Numër
Numri i kopshteve private në bashki	4	4	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	46	45	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki	1	1	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	6	6	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki	2	2	Numër
Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, i miratuar ose zbatuar	0	0	Po/Jo



MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni, bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore. Shembuj të aktiviteteve përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve; Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike); Dhënien e granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve; Monitorimin e ndotjes dhe koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit. Ky funksion rrjedh nga Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

Menaxhimi i mbetjeve në Bashkia Korçë paraqet një nga funksionet bazë të shërbimeve publike vendore dhe një element kyç për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Analiza e treguesve për periudhën **2024–2025** tregon se bashkia ka ruajtur mbulim të plotë territorial me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, duke garantuar akses të barabartë për popullsinë urbane dhe rurale, ndërkohë që paraqiten sfida në aspektin e mbulimit financiar të kostove të shërbimit.

Bashkia ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve të popullsisë urbane dhe rurale, duke u renditur ndër bashkitë me mbulim të lartë të këtij funksioni. Ruajtja e këtij standardi tregon stabilitet në ofrimin e shërbimit dhe aftësi institucionale për garantimin e aksesit ndaj menaxhimit të mbetjeve. Shërbimi bazohet në planin vendor të menaxhimit të mbetjeve, i cili është i miratuar dhe në zbatim, duke garantuar stabilitet dhe vijimësi institucionale në ofrimin e këtij funksioni bazë.

Analiza e performancës

Të dhënat tregojnë se Bashkia Korçë ka ruajtur **mbulimin e plotë të territorit** me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, duke garantuar akses të barabartë për popullsinë urbane dhe rurale. Paralelisht, është vërejtur **ulje e sasisë së mbetjeve të gjeneruara për banor**, një tregues pozitiv në aspektin mjedisor dhe mund të interpretohet si sinjal i eficiencës në përdorimin e burimeve, ndryshim i sjelljes së konsumit ose rritje të ndërgjegjësimit qytetar.

Në aspektin financiar, të ardhurat nga tarifa e shërbimit **janë rritur**, ndërkohë që kostot kanë shënuar rritje më të moderuar. Megjithatë treguesi i mbulimit të kostos nga tarifa ka pësuar një rënie të lehtë, niveli aktual mbetet relativisht i qëndrueshëm dhe tregon kapacitet të bashkisë për të mbështetur financiarisht shërbimin.


Tabelë: Arritjet dhe Objektivat

Kategoria	Përshkrimi
Arritjet 2025	- Mbulim i popullsisë urbane dhe rurale me shërbimin e mbetjeve. - Ulje e mbetjeve të gjeneruara për banor. - Rritje e të ardhurave nga tarifa. - Stabilitet institucional dhe operacional i shërbimit. - Vazhdimësi e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve.
Objektiva 2026	-Përmirësimi i eficiencës financiare të shërbimit. -Zhvillimi i infrastrukturë për ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve. -Nevojë për forcim të edukimit mjedisor.

Përfundime

Për të përmirësuar më tej performancën e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, rekomandohen:

- Investime në infrastrukturë për riciklim dhe ndarje në burim.
- Rritje e ndërgjegjësimit qytetar për reduktimin e mbetjeve.
- Optimizim i kostove operative dhe logjistikës së transportit.
- Forcim i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rajonal për menaxhim të integruar të mbetjeve.



A) Treguesit përmbledhës

Lloji	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	156.60	145.56	-11.04	↓	Përkeqësuar	●	-7.05%
Tregues	Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	80.50	79.41	-1.09	↓	Përkeqësuar	●	-1.35%
Tregues	Plani vendor I menaxhimit të mbetjeve I miratuar ose në zbatim	Numër	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

B) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Njësi administrative qendër të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	1	1	Cilësore
Numri fshatrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	63	63	Numër
Numri fshatrave në territorin e bashkise	63	63	Numër
Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	20176020	18704000	Kg
Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	166159	170486	mijë Lekë
Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	206403	214678	mijë Lekë
Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	128837	128495	Numër



MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrëfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret.

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri në Bashkinë Korçë përbën një funksion thelbësor për sigurinë publike dhe mbrojtjen e jetës e pronës së qytetarëve. Bashkia ka një strukturë funksionale të organizuar me **31 punonjës zjarrfikës** dhe **8 automjete operative**, të shpërndara në territor sipas zonave të riskut dhe dendësisë së popullsisë.

Megjithëse bashkia ka ruajtur një **nivel të qëndrueshëm të gatishmërisë operacionale**, të dhënat e vitit 2025 tregojnë **përmirësim në kapacitetet njerëzore**.

Treguesit e performancës

- **Zjarrëfikës për 1,500 banorë:** është rritur nga **0.32 në 0.36** (+12.05%), si rezultat i rritjes së numrit të punonjësve nga 28 në 31 dhe rënies të popullsisë (128,837 në 128,495 banorë).
- **Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë:** ka mbetur i pandryshuar për shkak të mungesës së ndryshimit në numrin e mjeteve (8 automjete). Ky kapacitet aktualisht nuk ka ndikuar në gadishmërinë e përgjithshme të shërbimit.

Analiza e performancës



- Në vitin 2025, shërbimi zjarrëfikës i Bashkisë Korçë ka ruajtur **funksionalitetin bazë dhe reagimin efektiv ndaj emergjencave lokale**, falë **përmirësimit të dukshëm në aspektin e burimeve njerëzore**, (duke rritur raportin e zjarrfikësve ndaj popullsisë) stafit të trajnuar dhe përvojës shumëvjeçare në terren. Ky zhvillim ndikon pozitivisht në kapacitetin e reagimit dhe në uljen e ngarkesës për personel.
- Megjithëse niveli i përgjithshëm i gatishmërisë mbetet i qëndrueshëm, **kapacitetet teknike kanë mbetur të pandryshuara**. Rekomandohet ndërhyrje për rinovimin e pajisjeve dhe përmirësimin e kushteve të punës së personelit. Në aspektin institucional, bashkia duhet të përgatisë një **Plan Vendor të Menaxhimit të Rrezeve nga Zjarri**, që të lidhë funksionin e mbrojtjes me planifikimin urban dhe mjedisor, sidomos për zonat pyjore dhe kullosore që përbëjnë pjesë të konsiderueshme të territorit.

Tabelë: Arritjet dhe Objektivat

Arritjet 2025	- Rritje e numrit të zjarrfikësve dhe përmirësim i raportit me popullsinë. - Ruajtje e funksionalitetit të plotë të shërbimit në të gjithë territorin. - Rritje e nivelit të gatishmërisë dhe reagimit emergjent. - Përvojë e konsoliduar e stafit zjarrëfikës dhe funksionim i pandërprerë i shërbimit.
Objektivat 2026	- Shtim dhe rinovim i flotës së mjeteve zjarrfikëse dhe pajisjeve mbrojtëse. - Përmirësim i kushteve të punës dhe pajisjeve për personelin. - Hartim i Planit Vendor për Mbrojtjen nga Zjarri dhe trajnime periodike për personelin. - Forcim i bashkëpunimit me Agjencinë e Emergjencave Civile dhe komunitetin lokal.

Përfundime

Bashkia Korçë paraqet **një përmirësim në kapacitetet njerëzore** në shërbimin zjarrëfikës duke rritur efektivitetin e reagimit ndaj emergjencave. Përmirësimet e mëtejshme duhet të fokusohen në modernizimin e pajisjeve dhe parandalimin e zjarreve në zonat pyjore dhe rurale, në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje efektive dhe e qëndrueshme ndaj emergjencave. Në vijim, bashkia synon të kalojë nga një qasje reaguese drejt një qasjeje parandaluese dhe planifikuese, në përputhje me standardet kombëtare të sigurisë civile dhe direktivat e Bashkimit Evropian për mbrojtjen nga zjarret.



A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbo l	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	Punonjës /1500 banorë	0.32	0.36	0.04	↑	12.5%	●
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	0.62	0.62	0.00	→	Pa ndryshim	●

B) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	28	31	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	128837	128495	Numër
Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	8	8	Numër

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i përgjithshëm: Funkcioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimin të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

Bashkia Korçë ka një nga territorët bujqësorë më të mëdhenj dhe më të mirëorganizuar në vend, me një **sipërfaqe prej 20317 hektarësh tokë bujqësore**, e cila përbën një bazë të

rëndësishme për zhvillimin ekonomik lokal.

Falë infrastrukturës së konsoliduar ujitëse dhe kulluese, **93.16%** e tokës bujqësore është e mbuluar me kanale funksionale të ujitjes dhe kullimit, duke siguruar kushte optimale për prodhim të qëndrueshëm dhe efikas të kulturave bujqësore.

Kjo e vendos Bashkinë Korçë në një pozicion të favorshëm krahasuar me mesataren kombëtare, ku shumë bashki ende vuajnë nga degradimi i rrjeteve ujitëse dhe kulluese.

Në territorin e saj operojnë **459 km kanale ujitëse dhe 494 km kanale kulluese**, funksionale, çka tregon mirëmbajtje dhe planifikim të qëndrueshëm teknik.

Treguesit kryesorë të performancës

- Sipërfaqja e tokës bujqësore e pajisur me kanale ujitjeje/kullimi: **93.16% (pa ndryshim nga viti 2024)**.
- Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale: **88.67 %**, një nivel i qëndrueshëm që tregon mirëmbajtje efektive dhe mungesë dëmtimesh të reja në sistem.
- Kanale ujitëse funksionale: **77.34 % e totalit**, që tregon që një pjesë e vogël ka nevojë për ndërhyrje të vogla për përmirësim.
- Kanale kulluese funksionale: **100%**, duke e vendosur këtë komponent si model të mirë administrimi.

Analiza e performancës

Performanca e Bashkisë Korçë në fushën e ujitjes dhe kullimit është **shumë e qëndrueshme**. Mbulimi i gjerë i tokës me rrjete ujitjeje dhe kullimi i plotë i tokave problematike janë tregues të koordinimit të mirë midis njësive bujqësore, shërbimeve publike dhe fermerëve. Megjithatë, **përqindja më e ulët e kanaleve ujitëse funksionale (77.34 %)** tregon për nevojën e investimeve shtesë në rehabilitimin e segmenteve të amortizuara dhe përfshirjen e komuniteteve të përdoruesve të ujit në mirëmbajtje.

Në këtë kuadër, bashkia duhet të synojë **modernizimin e sistemeve ujitëse**, sidomos në zonat me bujqësi intensive (Voskop- Bulgarec-Drenovë), duke përdorur teknologji të reja për menaxhimin efikas të ujit.

Tabelë: Arritjet dhe Objektivat



Arritjet 2025	- 93.16% e tokës bujqësore e mbuluar me rrjet ujitje e kullimi. - 100% funksionalitet në rrjetin kullues. - Mirëmbajtje e vazhdueshme e infrastrukturës ekzistuese.
Objektivat 2026	- Rehabilitim i segmenteve kryesore të rrjetit ujitës. - Hartim i planit të integruar për menaxhimin e ujit bujqësor. - Krijimi i mekanizmave të bashkëmenaxhimit me fermerët. - Aplikim për fonde të BE-së për investime në infrastrukturë ujitjeje.

Përfundime

Bashkia Korçë paraqet një **model të qëndrueshëm të menaxhimit të ujitjes dhe kullimit**, me mbulim të gjerë të tokave bujqësore dhe efikasitet të lartë në sistemet kulluese.

Sfida për periudhën në vijim qëndron në **modernizimin e rrjetit ujitës, përdorimin e teknologjive për kursimin e ujit dhe forcimin e bashkëpunimit me fermerët** si partnerë në mirëmbajtje dhe planifikim.

Ky është një funksion kyç për **rritjen e produktivitetit bujqësor dhe qëndrueshmërisë mjedisore** të territorit të bashkisë.



A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	93.16	93.16	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale	%	88.67	88.67	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	77.34	77.34	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

C) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	20317.00	20317.00	Hektarë
Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	18928.00	18928.00	Hektarë
Gjatësia e kanaleve ujitëse	459.00	459.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale	355.00	355.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese	494.00	494.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale	494.00	494.00	Kilometër (km)

 **ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE**

Përshkrim i përgjithshëm

Menaxhimi i fondit pyjor dhe kullosor në Bashkinë Korçë është një nga funksionet me ndikim të lartë në zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor dhe ekonomik të territorit. Bashkia zotëron një sipërfaqe prej **50,691.8 hektarësh pyje dhe kullota**, duke u renditur ndër bashkitë me fondin më të madh në nivel kombëtar. Shërbimi i pyjeve mbulon si ruajtjen, monitorimin dhe administrimin e pasurive pyjore e kullosore, ashtu edhe zbatimin e planeve të mbarështimit dhe angazhimin e komuniteteve lokale në përdorim të qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Në vitin 2025, bashkia ka ruajtur stabilitet institucional dhe kapacitete të qëndrueshme njerëzore, me **16 punonjës të dedikuar** për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor – ekuivalent me **0.32 punonjës për 1,000 ha**, me ndryshim të lehtë nga viti 2024.

Analiza e performancës

Të dhënat e vitit 2025 tregojnë një përmirësim shumë të ndjeshëm në shkallën e mbulimit me plane mbarështimi, nga **6.58% në 41.48 %**. Ky progres tregon një angazhim të dukshëm të bashkisë për të formalizuar administrimin e fondit pyjor dhe për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Në të njëjtën kohë, plani vendor i mbarështimit mbetet **i miratuar dhe në zbatim**, duke siguruar një kuadër teknik dhe ligjor për operimin e shërbimit.



Megjithëse kapacitetet njerëzore kanë mbetur **të qëndrueshme**, madhësia e territorit të mbuluar për punonjës është ende shumë e lartë, çka e bën sfiduese zbatimin efektiv të planeve, monitorimin e prerjeve, ndalimin e dëmeve dhe ruajtjen e biodiversitetit. Në këtë kuadër, bashkia duhet të orientohet drejt rritjes së numrit të punonjësve, investimeve në mjete teknike dhe teknologji digjitale për monitorim, si dhe forcimit të bashkëpunimit me strukturat rajonale dhe Agjencinë e Zonave të Mbrojtura.

Tabelë: Arritjet dhe Objektivat

Arritjet 2025	-Rritje e shkallës së mbulimit me plane mbarështimi nga 6.58% → 41.48%. -Miratim dhe zbatim i planit vendor të mbarështimit. -Rritje në numrin e punonjësve për administrimin e fondit pyjor (16 punonjës).
Objektivat 2026	- Rritja e mbulimit me plane mbarështimi mbi 50% të territorit. - Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe trajnimi i stafit për menaxhim të qëndrueshëm pyjor. -Përdorimi i mjeteve teknologjike për monitorimin e prerjeve, dëmeve dhe degradimit. -Bashkëpunim me komunitetet lokale dhe strukturat kombëtare për ruajtjen e fondit pyjor.

Përfundime

Bashkia Korçë ka shënuar një **hap të madh përpara në formalizimin e menaxhimit pyjor**, duke gjashtëfishuar mbulimin me plane dhe duke ruajtur strukturën institucionale. Përmirësimi i mëtejshëm kërkon **forcim të kapaciteteve teknike, rritje të stafit dhe koordinim më të ngushtë ndërinstitutional**, në mënyrë që mbrojtja e fondit pyjor dhe kullosor të jetë pjesë integrale e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të gjelbër të territorit të bashkisë.



A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor
Tregues	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●
Tregues	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	6.58	41.48	34.9	↑	Përmirësuar	●
Tregues	Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës/ 1000 ha	0.29	0.31	0.02	↑	Përmirësuar	●

B) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	1.00	1.00	Cilësore (Po/Jo)
Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki	50691.80	50691.80	Hektarë
Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plan mbarështimi	3333.00	21026.54	Hektarë
Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	15.00	16.00	Numër



MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm

Funkcioni i mbrojtjes sociale në Bashkinë Korçë mbetet një ndër prioritetet e administratës vendore për të garantuar përfshirje sociale, barazi dhe akses të barabartë në shërbime për grupet vulnerabël. Bashkia ka një rrjet të qëndrueshëm qendrash sociale **(10 ditore dhe 4 rezidenciale)** që ofrojnë shërbime për kategori të ndryshme përfituesish, si persona me aftësi të kufizuara (PAK), të moshuar, gra në situatë dhune dhe familje me vështirësi ekonomike.

Në vitin 2025, bashkia ka ruajtur zbatimin e plotë të **Planit Vendor Social**, si instrumenti kryesor për planifikimin dhe koordinimin e politikave sociale, ndërkohë që ka shënuar përmirësime në

mbulimin e disa kategorive përfituesish dhe në funksionimin e mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR).

Treguesit kryesorë të performancës

- **Familjet përfituese nga ndihma ekonomike janë rritur** nga 651 në 729 duke reflektuar zgjerim të mbulimit të këtij instrumenti, me një rritje prej **(+11.40%)** në raport me vitin 2024, kjo pasi dhe numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike është rritur për vitin 2025. Mbulimi ndaj aplikimeve mbetet i lartë (**94.31 %**) çka tregon për vazhdimësi në ofrimin e mbështetjes sociale ndaj familjeve në nevojë.
- **Shkalla e miratimit të strehimit social:** Edhe shkalla e miratimit të strehimit social ka shënuar një rritje të lehtë, nga **56.97% në 59.52%**. Megjithatë familjet që nuk përfitojnë nga strehimi social (mosplotësim kushtesh) mbështeten sipas kategorive për të përfituar nga programet e tjera të këtij shërbimi.
- **Në drejtim të infrastrukturës sociale,** numri i qendrave sociale komunitare publike për 10,000 banorë mbetet i pandryshuar (**1.09**), duke treguar stabilitet në ofrimin e këtij shërbimi.
- **Rastete e dhunës në familje dhe format e të tjera** të referuara nga MKR janë ulur ndjeshëm nga 122 raste në 2024 në 97 raste në vitin 2025 si rezultat i ndërhyrjeve të vazhdueshme sociale dhe aktiviteteve sensibilizuese .Sa i përket mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR), përqindja e rasteve të referuara që përfitojnë shërbime sociale ka pësuar rënie, nga **69.67% në 56.70%**. Kjo tendencë reflektohet edhe në nën-treguesit sipas gjinisë dhe grupmoshave, ku vërehen ulje në përqindjen e përfitimit për disa grupmosha (veçanërisht 30–44 dhe 45–59 vjeç), ndërsa për grupmoshën 18–29 vjeç evidentohet rritje.
- **Përqindja e personave me aftësi të kufizuara** që marrin mbështetje të integruar është rritur nga **6.92% në 11.01%**, me rritje më të dukshme për të dyja gjinitë si dhe grupmoshave PAK duke reflektuar ndërhyrje më efektive në shërbimet e specializuara.

Analiza e performancës

Performanca e Bashkisë Korçë në fushën e mbrojtjes sociale **është e qëndrueshme** dhe në **progres**. Ndërhyrjet janë përqendruar në forcimin e shërbimeve ekzistuese, ruajtjen e rrjetit të qendrave ditore dhe integrimin më të mirë të mekanizmit të referimit. Përmirësimi i indikatorëve që lidhen me PAK dhe rastet e dhunës në familje tregon rritje të aftësisë institucionale për identifikim dhe ndjekje të rasteve vulnerabël.


Tabelë: Arritjet dhe Objektivat

Arritjet 2025	-Zbatim i plotë i Planit Vendor Social. - Përmirësim i mbështetjes për PAK - Ulje e rasteve të dhunës - Rritje e përfshirjes së grave dhe grupmoshës së re në shërbime sociale.
Objektivat 2026	- Zgjerim i shërbimeve sociale për familjet vulnerabël dhe grupet me të ardhura të ulëta. - Rritje e mbulimit me programe të strehimit social. - Integrim gjinor dhe buxhetim me ndjeshmëri gjinore në politikat sociale.

Përfundime

Bashkia Korçë ka patur përmirësim në ofrimin e shërbimeve sociale, falë përmirësimit të koordinimit institucional. Sfidat mbetet **përforcimi i politikave të përfshirjes ekonomike dhe sociale** për familjet në nevojë, si dhe **zbatimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse gjinore** në planifikimin e shërbimeve.

Në vijim, prioritet duhet të jetë **zgjerimi i rrjetit të shërbimeve sociale dhe rritja e efikasitetit të mbështetjes financiare**, në përputhje me objektivat kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm dhe përfshirje sociale.



Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trend i	Simbo l	% Ndryshimi	Semaf or
Tregues	Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	84.66	94.31	9.65	↑	11.40 %	●
Tregues	Shkalla e miratimit të strehimit social	%	56.97	59.52	2.55	↑	4.48%	●
Tregues	Numri i qendrave sociale komunitare publike, të licensuara për 10,000 banorë	qendra/10,000 banorë	1.09	1.09	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	69.67	56.70	-12.97	↓	- 18.62 %	●
Tregues	Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	6.92	11.01	4.09	↑	59.10 %	●
Tregues	Plan vendor social	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Përqindja e rasteve femra të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	71.43	55.84	-15.58	↓	- 21.82 %	●
Nëntregues	Përqindja e rasteve meshkuj të referuar nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	62.50	60.00	-2.50	↓	- 4.00%	●
Nëntregues	Përqindja e rasteve grupmosha 0-17 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Përqindja e rasteve grupmosha 18-29 vjeç të referuara nga mekanizmi i	%	46.67	72.73	26.06	↑	55.84 %	●

	koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale							
Nëntregues	Përqindja e rasteve grupmosha 30-44 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	80.00	42.86	-37.14	↓	-46.43 %	●
Nëntregues	Përqindja e rasteve grupmosha 45-59 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	61.0	-39.0	↓	-39.0%	●
Nëntregues	Përqindja e rasteve grupmosha 60+ vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	52.00	56.25	4.25	↑	8.17%	●
Nëntregues	Përqindja e femrave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	5.5	11.68	6.15	↑	111%	●
Nëntregues	Përqindja e meshkujve me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	7.8	10.5	2.7%	↑	34.6%	●
Nëntregues	Përqindja e personave grupmosha 0-17 vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	9.20	54.67	45.47	↑	495%	●
Nëntregues	Përqindja e personave grupmosha 18+ vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	6.20	8.67	2.47	↑	39.83 %	●

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike	769	773	Numër
Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike	651	729	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	128837	128495	Numër
Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social	165	168	Numër
Numri i personave përfitues të strehimit social	94	100	Numër
Numri i qendrave sociale ditore funksionale	10	10	Numër
Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale	4	4	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit	122	97	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale	85	55	Numër
Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale	1445	1471	Numër
Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit	100	162	Numër
Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuargjatë periudhës së raportimit	1	1	Cilesore(Po=1/Jo=0)

QEVERISJA E MIRE

Qeverisja e mirë përfaqëson aftësinë institucionale të bashkisë për të ushtruar përgjegjësitë publike me integritet, transparencë dhe efikasitet, duke garantuar përfshirjen qytetare dhe barazinë e mundësive. Në kuadër të matjes së performancës vendore, qeverisja e mirë vlerësohet përmes katër fushave përfaqësuese, të cilat reflektojnë cilësinë e proceseve të brendshme dhe kapacitetin administrativ për të siguruar rezultate të qëndrueshme:

1.  Burimet Njerëzore – masin strukturën, stabilitetin dhe profesionalizmin e administratës vendore, si dhe nivelin e zhvillimit të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore.
2.  Transparenca – tregon nivelin e hapjes së informacionit dhe komunikimit me qytetarët, publikimin e akteve dhe respektimin e standardeve të qeverisjes së hapur.
3.  Barazia Gjinore – reflekton përpjekjet institucionale për të siguruar përfaqësim të barabartë dhe përfshirje gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe politikëbërjes lokale.
4.  Integrimi në BE – mat aftësinë e bashkisë për të përafruar praktikën e saj me standardet evropiane, përmes projekteve bashkëpunuese, partneriteteve ndërbashkiake dhe strukturave të dedikuara të integritetit.



BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit – duke përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin aktiv dhe të larguar. Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për 1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë strukturore (administratë ose njësi shpenzuese).

Përshkrim i përgjithshëm

Burimet njerëzore përbëjnë një element kyç në funksionimin dhe performancën e Bashkisë Korçë. Në vitin 2025, administrata bashkiake ka **ruajtur stabilitet në strukturë dhe funksione**, duke pasur një total prej **1,143 punonjësish** (krahasuar me 1,124 në vitin 2024). Rritja e lehtë e stafit reflekton përforcimin e disa sektorëve teknikë dhe shërbimeve publike, si pastrim, mirëmbajtje dhe mbrojtje sociale.

Treguesit e performancës


- **Shkalla e rotacionit të punonjësve** është ulur ndjeshëm nga **12.81% në 10.67%** (-16.70%) çka tregon për **qëndrueshmëri më të madhe të stafit** dhe kushte pune më të qëndrueshme në administratë.
- **Punonjës për 1,000 banorë:** është rritur lehtë nga **9.81 në 9.88** (+0.71%) duke reflektuar përmirësim në raportin e mbulimit administrativ dhe ofrimit të shërbimeve.
- **Përqindja e stafit të trajnuar** është rritur nga **7.29 % në 8.04 %** (10.28%), duke sinjalizuar përmirësim të investimeve në zhvillimin profesional të punonjësve.
- **Përqindja e stafit femra të trajnuar** është rritur me **11.03%**, nga **10.15% në 11.27 %** ndërsa ajo e stafit meshkuj me **8.88%**, nga **4.73% në 5.15%**, duke përmirësuar balancën gjinore në zhvillimin e kapaciteteve.
- **Stafi i administarës** ka përfituar më shumë trajnime **(+28.16 %)** krahasuar me Njësitë shpenzuese.


Tabelë: Arritjet dhe Objektivat

Arritjet 2025	- Ulje e rotacionit të stafit. - Rritje e përqindjes së stafit të trajnuar. - Rritje e pjesëmarrjes së grave në programe trajnimi . - Stabilitet në numrin e punonjësve dhe përmirësim i raportit shërbim–banor.
Objektivat 2026	- Rritje e trajnimeve profesionale me fokus në aftësi digjitale, inovacion administrativ dhe menaxhim projektsh. - Ulja e rotacionit të punonjësve. - Hartim i një Plani të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore 2026–2028 me fokus te karriera dhe përfshirja gjinore.

Përfundime

Bashkia Korçë ka konsoliduar **një administratë të qëndrueshme dhe të motivuar**, duke treguar progres në profesionalizim dhe barazi gjinore. **Reduktimi i rotacionit** dhe rritja e trajnimeve janë tregues të qartë të maturimit institucional. Sfida e ardhshme është të garantohet që ky progres të shndërrohet në cilësi më të lartë të shërbimeve publike, përmes digjitalizimit, inovacionit administrativ dhe zhvillimit të karrierës së stafit.





A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trend i	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë	%	12.81	10.67	-2.14	↓	- 16.70 %	●
Tregues	Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar	%	7.29	8.04	0.75	↑	10.28 %	●
Tregues	Punonjës për 1000 banorë	Punonjës/1000 banorë	9.81	9.88	0.07	↑	0.71%	●
Nëntregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve femra të bashkisë	%	12.78	8.31	-4.47	↓	- 34.97 %	●
Nëntregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve meshkuj të bashkisë	%	12.84	12.79	-0.05	↓	- 0.38%	●
Nëntregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të administratës të bashkisë	%	7.19	11.68	4.49	↑	62.44 %	●
Nëntregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të njësive shpenzuese të bashkisë	%	14.65	10.32	-4.33	↓	- 29.55 %	●
Nëntregues	Përqindja e stafit femra të trajnuar	%	10.15	11.27	1.12	↑	11.03 %	●
Nëntregues	Përqindja e stafit meshkuj të trajnuar	%	4.73	5.15	0.42	↑	8.88%	●
Nëntregues	Përqindja e stafit të administratës të trajnuar	%	13.67	17.52	3.85	↑	28.16 %	●
Nëntregues	Përqindja e stafit të njësive shpenzuese të trajnuar	%	5.20	4.81	-0.39	↓	- 7.5%	●

A) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit	1124	1143	Numër
Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	144	122	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	128837	128495	Numër
Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit	82	92	Numër
Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit	140	127	Numër



TRANSPARENCA

Të dhëna të Përgjithshme: Transparenca në pushtetin vendor është parimi që siguron që qytetarët të kenë qasje të lirë dhe të kuptueshme në informacionin publik, dokumentet zyrtare, si dhe proceset vendimmarrëse të njësisë vendore. Ajo nënkupton publikimin e vendimeve, buxhetit, planeve dhe raporteve të ndryshme, duke mundësuar që qytetarët të jenë të informuar, të përfshihen në konsultime publike dhe të kërkojnë llogari nga institucionet lokale për veprimet apo mosveprimet e tyre. Transparenca forcon besimin mes qytetarëve dhe qeverisjes vendore, dhe ndihmon në parandalimin e abuzimeve apo korrupsionit.

Përshkrim i përgjithshëm

Transparenca institucionale mbetet një shtyllë thelbësore e qeverisjes së mirë në Bashkinë Korçë, duke reflektuar angazhimin për llogaridhënie dhe pjesëmarrje qytetare në proceset vendimmarrëse. Bashkia ka vijuar zbatimin e praktikave të konsoliduara për konsultimet publike dhe publikimin e akteve që kërkojnë transparencë të plotë në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Në vitin 2025, bashkia ka ruajtur **përfshirje të plotë në proceset e konsultimeve publike**, duke zhvilluar konsultime për **100% të akteve për të cilat është e detyrueshme**, ndërsa plani vendor i integritetit **nuk është miratuar** apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit.

Treguesit kryesorë të performancës

- **Akte për të cilat është zhvilluar konsultimi publik:** 100% e rasteve, duke treguar zbatim të plotë të kërkesave ligjore dhe përfshirje aktive të publikut në vendimmarrje.
- **Plani Vendor i Integritetit:** mungon ende si dokument i miratuar, duke kufizuar strukturimin e politikave të parandalimit të korrupsionit dhe forcimit të etikës publike.

Analiza e performancës

Bashkia Korçë ka arritur **standarde të larta në zbatimin e konsultimeve publike**, duke u siguruar që çdo akt me ndikim publik të kalojë në proces të hapur konsultimi. Ky nivel përfshirjeje është një arritje e rëndësishme dhe dëshmi e një **kulture administrative të konsoliduar për transparencë**.

Megjithatë, mungesa e **Planit të Integritetit Vendor** kufizon vlerësimin e brendshëm dhe monitorimin sistematik të masave kundër korrupsionit. Në këtë drejtim, bashkia ka nevojë të forcojë **mekanizmat e vetëvlerësimit** duke krijuar lidhje të drejtpërdrejtë midis planifikimit, transparencës dhe integritetit institucional.


Tabelë: Arritjet dhe Objektivat

Arritjet 2025	- Zbatim i plotë i konsultimeve publike për 100% të akteve që kërkojnë transparencë. - Vlerësim pozitiv për komunikimin publik dhe aksesin në informacion.
Objektivat 2026	- Hartim dhe zbatim i Planit Vendor të Integritetit 2026–2028. - Zhvillimi i trajnimeve për etikën publike dhe qeverisjen e ndershme.

Përfundime

Bashkia Korçë paraqet një **shembull pozitiv në zbatimin e konsultimeve publike dhe pjesëmarrjes qytetare**, por për të arritur standardet më të larta të qeverisjes së mirë duhet të përfshijë **raportimin periodik dhe planifikimin e integritetit** si pjesë të pandashme të sistemit të saj institucional.

Forcimi i transparencës nuk qëndron vetëm te njoftimi i vendimeve, por edhe te **monitorimi, vetëvlerësimi dhe përfshirja e komunitetit në çdo fazë të procesit vendimmarrës**.



A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semaf or
Tregues	Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Cilësore (Po=1/Jo=0)	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Plani Vendor i Integritetit	Cilësore (Po=1/Jo=0)	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●

B) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	6	8	Numër
Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik	6	8	Numër
Publikimi i raportit vjetor për transparencën	0	0	Cilësore (Po=1/Jo=0)
Plani Vendor i Integritetit, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0	0	Cilësore (Po=1/Jo=0)



BARAZIA GJINORE

Përshkrim i përgjithshëm:

Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkitë duhet të garantojnë: • pjesëmarrje të barabartë gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe administrative; • buxhetim të përgjigjshëm gjinor (gender-responsive budgeting), sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi; • ofrim shërbimesh që

adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre; • mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor dhe dhuna me bazë gjinore. Bashkitë janë të detyruara të raportojnë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione kyçe, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Barazia gjinore në Bashkia Korçë përbën një element të rëndësishëm të qeverisjes vendore dhe të garantimit të përfaqësimit të drejtë në strukturat politike dhe administrative. Analiza e treguesve për periudhën 2024–2025 tregon se bashkia ka ruajtur një nivel relativisht të qëndrueshëm të përfshirjes së grave në pozicione drejtuese, megjithëse vihet re një rënie e lehtë në disa tregues të përfaqësimit gjinor.

Të dhënat tregojnë se përqindja e grave në pozicione politike dhe administrative vendimmarrëse, si kryetare, zv.kryetare, administratore dhe anëtare të këshillit bashkiak, ka pësuar një rënie të lehtë nga **36.36%** në vitin 2024 në **35.18%** në vitin 2025. Kjo rënie lidhet me uljen e numrit të grave në këto pozicione nga 20 në 19, ndërkohë që numri total i pozicioneve ka pësuar një reduktim të lehtë nga 55 në 54. Megjithëse ndryshimi nuk është i theksuar, ai sinjalizon nevojën për forcimin e politikave që mbështesin ruajtjen dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje.

Në aspektin administrativ, gratë vijojnë të mbajnë një peshë të konsiderueshme në strukturat drejtuese të bashkisë. Përqindja e grave në pozicione drejtuese të niveleve të ndryshme ka kaluar nga **55.26%** në **53.84%**. Edhe pse numri i grave në këto role ka mbetur i pandryshuar (21 gra), rritja e numrit total të pozicioneve drejtuese nga 38 në 39 ka ndikuar në uljen proporcionale të përfaqësimit. Ky tregues konfirmon se bashkia vijon të ketë një administratë relativisht të balancuar në aspektin gjinor, veçanërisht në sektorët socialë, arsimorë dhe administrativë.

Analiza e performancës

Në planin institucional, Bashkia Korçë paraqet një nivel të mirë përfaqësimi gjinor në administratë, duke reflektuar stabilitet organizativ dhe respektim të parimeve të barazisë në procedurat e rekrutimit dhe promovimit.

Megjithatë, rënia e lehtë e treguesve tregon se ruajtja e kësaj balance kërkon masa të vazhdueshme mbështetëse dhe politika aktive për avancimin e grave në nivelet vendimmarrëse. Në nivel politik, përfaqësimi i grave mbetet relativisht i qëndrueshëm, por nën synimin e vendosur nga **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030**, që parashikon përfaqësim minimal prej **40%**.


Gjithashtu, përqindja e lartë e grave në administratë tregon për balancim real në vendimmarrjen ekzekutive, veçanërisht në nivel drejtuesish. Kjo prirje duhet të shoqërohet me politika për zhvillimin profesional dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në sektorë teknikë, financiarë dhe inxhinierikë, ku tradicionalisht përfaqësimi i grave mbetet më i kufizuar. Zbatimi efektiv i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore do të jetë një instrument kyç për konsolidimin e progresit të arritur dhe për adresimin e sfidave ekzistuese në drejtim të barazisë gjinore në nivel vendor.

Tabelë: Arritjet dhe Objektivat

Arritjet 2025	- Përfaqësim i lartë i grave në pozicione drejtuese. - Përfaqësim i qëndrueshëm në këshillin bashkiak. - Vlerësim pozitiv për balancën gjinore në strukturat menaxheriale të bashkisë. Hartimi dhe miratimi i Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2025–2027.
Objektivat 2026	- Integrimi i perspektivës gjinore në buxhetin vendor dhe projektet sektoriale. - Rritje e pjesëmarrjes së grave në fushat me ndikim të lartë ekonomik dhe teknik. - Trajnime dhe rrjete profesionale për avancimin e grave në vendimmarrje.

Përfundime

Bashkia Korçë paraqet një **shembull të qëndrueshëm për barazinë gjinore në administratën publike lokale**, me përfaqësim të balancuar dhe një bazë të fortë për zhvillimin e politikave të avancuara të integritimit gjinor. Sfida kryesore për periudhën në vijim është **kthimi i barazisë gjinore nga praktikë institucionale në politikë të dokumentuar**, buxhetimit të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe përfshirjes së grave në fushat strategjike të zhvillimit vendor.



Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semaf or
Tregues	Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore	%	36.36	35.18	-1.18	↓	-3.24%	●
Tregues	Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	%	55.26	53.84	-1.42	↓	-2.56%	●
Tregues	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore	Cilësore (Po/Jo)	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%	●

Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).	55	54	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore	20	19	Numër
Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	38	39	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	21	21	Numër
Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0	1	Cilësore (Po=1/Jo=0).

EU INTEGRIMI NË BE

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, përfshirë pushtetin vendor. Bashkitë luajnë një rol kritik në afërsimin me *acquis communautaire* dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkive u rekomandohet të:

- Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;
- Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikën e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale
- Fuqizojnë rolin e komuniteteve në procesin e integrimit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të besimit publik.

Integrimi në Bashkimin Evropian mbetet një prioritet strategjik i Bashkisë Korçë, i cili ndërthuret ngushtë me përmirësimin e qeverisjes vendore, menaxhimit të performancës dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Bashkia ka ruajtur një **strukturë funksionale për integrimin evropian**, e cila është përfshirë në organizimin institucional dhe koordinon projektet dhe nismat me financim të BE-së në bashkëpunim me sektorët e tjerë teknikë. Në vitin 2025, bashkia ka shënuar **progres të dukshëm në përfshirjen në projekte të BE-së**, duke kaluar nga 2 projekte të fituara në vitin 2024 në **5 projekte të fituara nga 5 të aplikuarat**, me një **raport suksesi prej 100%**. Ky është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve për të përfituar fonde evropiane dhe për të përmirësuar standardet e menaxhimit të ciklit të projektit.

Treguesit kryesorë të performances

- **Raporti i projekteve të fituara ndaj të aplikuarave:** 100% në vitin 2025 (nga 15.38 % në 2024), që tregon rritje të ndjeshme të kapaciteteve për përgatitje projektesh cilësore dhe bashkëpunim ndërkombëtar.
- **Komisionet e Integrimit Evropian pranë Këshillit Bashkiak:** janë ngritur dhe funksionale, duke mundësuar koordinim të rregullt ndërmjet këshilltarëve dhe administratës.
- **Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës:** është i miratuar dhe në zbatim, duke siguruar lidhje midis politikave lokale të zhvillimit dhe qasjes së BE-së për qeverisjen shumë-nivelëshe.
- **Marrëveshjet ndërbashkiake (brenda vendit) :** janë zgjeruar gjatë vitit 2025 (krahasuar me vitin 2024), çka tregon për forcim të bashkëpunimit horizontal me bashki të tjera në kuadër të programeve ndërkufitare dhe të bashkëpunimit territorial.

Analiza e performancës


Bashkia Korçë ka demonstruar përmirësim të qartë në pjesëmarrjen në programe të BE-së. Funksionimi i strukturës së integritetit dhe ekzistenca e planit për migracionin e diasporën përbëjnë bazën institucionale për harmonizimin me prioritetet e BE-së, veçanërisht në fushat e qeverisjes vendore, zhvillimit të qëndrueshëm dhe integritetit ekonomik rajonal. Lidhja e marrëveshjeve ndërbashkiake (brenda vendit) tregon se bashkia ende ka shfrytëzuar mundësitë e bashkëpunimit ndërterritorial, një element i rëndësishëm në procesin e integritetit.

Përmirësimi i mëtejshëm kërkon forcim të strukturave të menaxhimit të projekteve, ndërtim të partneriteteve ndërkombëtare dhe rritje të kapaciteteve për të përgatitur aplikime konkurruese në thirrjet e reja të BE-së (IPA III, Interreg, Horizon Europe etj.).


Tabelë: Arritjet dhe Objektivat

Arritjet 2025	- Rritje e projekteve të fituara nga BE (5 nga 5, 100%). - Strukturë funksionale për integrimin evropian. - Komisionet e integritetit pranë Këshillit Bashkiak funksionale. - Plani i miratuar i migracionit dhe diasporës në zbatim. - Marrëveshje ndërbashkiake
Objektivat 2026	- Nënshkrimi i të paktën një marrëveshjeje ndërbashkiake të re (brenda vendit) të re. - Zgjerim i partneriteteve me bashki të rajonit dhe rrjete ndërkombëtare. - Përdorim strategjik i Planit të Migracionit dhe Diasporës për tërheqje investimesh dhe pjesëmarrje komunitare. - Nevojë për përfshirje më të fortë të këshillit bashkiak në proceset e integritetit.

Ngritja e komisioneve të integrimit evropian dhe plan i migracionit dhe diasporës, cilësore, 2024-2025



Projekte të fituara kundrejt projekte të aplikuara, %, 2024-2025



Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	Semaf or
Tregues	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki	Numër	0.00	2.00	2.00	↑	●
Tregues	Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian	%	15.38	100.00	84.62	↑	●
Tregues	Planet e migracionit dhe diasporës	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	●
Tregues	Komisionet e integritetit evropian pranë këshillave bashkiakë	Cilësore (Po=1/Jo=0)	1.00	1.00	0.00	→	●

) Shtojcë: Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara	0.00	2.00	Numër
Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës së raportimit	13.00	5.00	Numër
Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës së raportimit	2.00	5.00	Numër
Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=Bosh).
Komisionet e Integritetit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	1.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=Bosh).

MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e

vetëqeverisjes vendore”. Kjo kategori ndahet në tre fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet, dhe buxheti. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizimin e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Në Bashkinë Korçë, në drejtim të të ardhurave, të ardhurat e veta për frymë janë rritur nga **7,823.33 në 8,314.63** lekë për banor. Në të njëjtën kohë, të ardhurat nga taksa e pasurisë në raport me të ardhurat vendore kanë shënuar një rritje nga **17.63% në 18.44%** duke reflektuar përmirësim në administrimin fiskal lokal.

Të ardhurat e veta kanë pësuar rritje krahasuar me vitin 2024, ashtu sikurse janë rritur dhe transfertat gjithësej. Megjithatë raporti i të ardhurave të veta ndaj transfertave ka pësuar një ulje nga **91.68% në 88.61%**, ndërsa pesha e të ardhurave të veta ndaj buxhetit është ulur lehtë nga **47.83% në 46.98%**.

Sa i përket përdorimit të të ardhurave dhe ekzekutimit të buxhetit, vërehet një rënie në shkallën e përdorimit të të ardhurave (**nga 92.01% në 88.43%**) dhe në shkallën e ekzekutimit të buxhetit (**nga 76.38% në 74.63%**). Në drejtim të detyrimeve financiare, pesha e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve mbi afatin 30 ditë, ka shënuar ulje nga **4.38% në 4.14%**, duke përmirësuar shëndetin financiar të bashkisë.



Struktura e shpenzimeve paraqet ndryshime ndërmjet kategorive kryesore. Pesha e shpenzimeve për personelin në buxhet është rritur nga **46.54% në 51.75%** për shkak të rritjes së nivelit të pagave nga zbatimi i VKM nr. 503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në VKM Nr.328, Datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e Njësive të Vetëqeverisjes vendore , për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të NJVV” ndërsa pesha e shpenzimeve operacionale është ulur nga **43.62% në 40.92%**. Në tërësi, treguesit financiarë reflektojnë rritje të të ardhurave për frymë dhe të buxhetit të planifikuar, ndërkohë që evidentohet ulje në peshën që zenë investimet në buxhet gjatë periudhës së analizuar.

Përfundime

Bashkia Korçë ka demonstruar **stabilitet financiar dhe administrim të kujdesshëm të burimeve publike**.

Përmirësimi i arkëtimeve nga taksat vendore dhe ulja e detyrimeve tregojnë **përgjegjshmëri fiskale dhe orientim drejt zhvillimit të qëndrueshëm**.

Në vijim, fokusi duhet të qëndrojë në **forcimin e menaxhimit të financave publike në nivel lokal**.



Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera (viti i kaluar)	Vlera (viti aktual)	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Të ardhurat e veta për frymë	leke/person	7823.33	8314.63	491.30	↑	6.27%	●
Tregues	Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	%	91.68	88.61	-3.07	↓	-3.35%	●
Tregues	Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	%	47.83	46.98	-0.85	↓	-1.78%	●
Tregues	Shkalla e përdorimit të të ardhurave	%	92.01	88.43	-3.58	↓	-3.89%	●
Tregues	Të ardhurat nga taksa e pasurisë ne raport me të ardhurat vendore	%	17.63	18.44	0.81	↑	4.60%	●
Tregues	Buxheti i miratuar për frymë	leke/person	19703.11	20971.42	1268.31	↑	6.44%	●
Tregues	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit	%	76.38	74.63	-1.75	↓	-2.29%	●
Tregues	Investime për frymë	leke/person	1480.96	1146.90	-334.06	↓	-22.56%	●
Tregues	Pesha e investimeve në buxhet	%	9.84	7.33	-2.51	↓	-25.50%	●
Tregues	Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve mbi 30 ditë	%	4.38	4.14	-0.24	↓	-5.47%	●
Tregues	Pesha e personelit në buxhet	%	46.54	51.75	5.21	↑	11.19%	●
Tregues	Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	%	43.62	40.92	-2.7	↓	-6.18%	●

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Të ardhurat e veta, fakt	1007935	1068389	Mijë Leke
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	128837	128495	Numër
Transferrat gjithsej, fakt	1099433	1205760	Mijë Leke
Të ardhurat e përgjithshme, fakt	2107368	2274149	Mijë Leke
Totalit i shpenzimeve të bashkisë , fakt	1938953	2011038	Mijë Leke
Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt	177732	197051	Mijë Leke
Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar	2538490	2694722	Mijë Leke
Shpenzime kapitale, fakt	190802	147371	Mijë Leke
Detyrime të papaguara mbi 30 ditë	84997	83216	Mijë Leke
Shpenzime personeli, fakt	902304	1040790	Mijë Leke
Shpenzime operationale, fakt	845847	822877	Mijë Leke

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përfundim të analizës së performancës për vitin 2025, **Bashkia Korçë** paraqitet si një njësi vendore me **administratë të konsoliduar, kapacitete të qëndrueshme dhe rezultate të dukshme** në ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët e saj.

Shumica e treguesve të vlerësuar tregojnë **stabilitet dhe përmirësim gradual** në krahasim me vitin e kaluar për pjesën më të madhe të treguesve.

Bashkia ka arritur të ruajë një **nivel të lartë transparence dhe llogaridhënieje publike**, duke garantuar konsultime të rregullta me komunitetin dhe përfaqësim të balancuar gjinor në strukturat e vendimmarrjes.

Në të njëjtën kohë, performanca fiskale dhe ekzekutimi i buxhetit dëshmojnë për **menaxhim të kujdesshëm financiar**.

Megjithatë, bashkia përballët me **sfida të natyrës socio-ekonomike**, si tkurrja demografike, migracioni i të rinjve dhe nevoja për rigjallërim të ekonomisë rurale. Këto sfida kërkojnë **planifikim të integruar zhvillimor**, forcim të partneriteteve me biznesin dhe komunitetin, si dhe më shumë projekte që nxisin punësimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Ky raport dëshmon përkushtimin e Bashkisë Korçë për **të ndërtuar një qeverisje më efektive, transparente dhe të afërt me qytetarin**, duke vijuar në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe integritetit evropian